



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 janar 2022
Nr.ref.:RK 1934/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI
në

rastin nr. KI136/20

Parashtrues

Enver Maloku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [ARJ-
UZVP.nr. 107/2019], i 9 dhjetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Enver Maloku (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), nga Komuna e Gjilanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [ARJ-UZVP.nr. 107/2019], të 9 dhjetorit 2019, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [A.Anr.373/2018], të 8 majit 2019, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [A.nr.1937/16], e 15 marsit 2018, të Gjykatës Themelore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës kishte pranuar Aktgjykimin e kontestuar më 20 gusht 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 7 [Vlerat], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 shtator 2020, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 24 shtator 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
8. Më 30 shtator 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë.
9. Më 30 shtator 2020, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të sjellë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar.
10. Më 2 tetor 2020, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletkthesën e kërkuar.
11. Më 15 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument shtesë lidhur me rastin e tij.

12. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
13. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
14. Me 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohej kryesuese e Kolegjeve shqyrtuese në rastet në të cilët ajo ishte caktuar anëtare e Kolegjit, përfshirë edhe rastin aktual.
15. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP-71-2/21], gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese
16. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka Nimani, përmes Vendimit Nr. KI136/20, caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi si anëtarë kolegji.
17. Më 10 dhjetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

18. Më 8 korrik 2016, parashtruesi i kërkesës e pranoi raportin e kontrollit mbi tatimin të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (në tekstin e mëtejme: ATK).
19. Me këtë njoftim, pas kontrollit të bazuar në librat e regjistrimit të parashtruesit të kërkesës, ATK-ja ka përcaktuar se parashtruesi është i detyruar t'i paguaj detyrimet e tatimit mbi vlerën e shtuar (në tekstin e mëtejme: TVSH) në vlerë prej 46,983.50 €, si dhe gjobën në vlerë prej 25%, për periudhën 1 prill 2010 deri me 31 dhjetor 2015.
20. Më 30 gusht 2016, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë (nr. 33/2016) në ATK, Departamenti për ankesa, kundër raportit të kontrollit të 8 korrikut 2016 të lëshuar nga ATK-ja.
21. Më 23 shtator 2016, ATK-ja Departamenti për ankesa (Vendimi nr. 333/2016) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

22. Më 13 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi kundër të paditurës ATK në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal.
23. Parashtruesi i kërkesës në padi ka pretenduar se ATK-ja, në rastin kur e ka ngarkuar parashtruesin e kërkesës si tatimpagues me TVSH, në mënyrë të gabuar ka interpretuar dhe zbatuar dispozitat e Ligjit për TVSH-në, për shkak se ATK parashtruesin e kërkesës e ka trajtuar si biznes, përkatësisht si person juridik, ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk ka ushtruar veprimtari afariste dhe nuk ka realizuar ndonjë transaksion biznesi. Me tej, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Themelore kishte theksuar se parat në llogarinë e tij personale janë trajtuar si të hyra biznesore pa asnjë fakt dhe prove dhe rrjedhimisht është ngarkuar me tatim.
24. Ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës kishte propozuar edhe caktimin e një eksperti financiar në mënyrë që të konstatoj drejtë gjendjen faktike në rastin e tij.
25. Më 15 mars 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A. nr. 1937/16] e refuzoj kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, si të pabazuar me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte arritur që të i mbështes pretendimet e tij me prova materiale lidhur me prejardhjen e deponimeve bankare gjatë periudhës 2011 deri në 2015 dhe nuk kishte paraqitur librat e regjistrit në mënyrë që të vërtetohet gjendja faktike para kontrollit dhe rrjedhimisht konfirmoi Vendimin [nr.333/2016] e ATK-së së 23 shtatorit 2016.
26. Gjithashtu, Gjykata Themelore kishte refuzuar propozimin për ekspertizë financiare lidhur me origjinën e deponimeve bankare me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar ndonjë dokumentacion/provë që ndërlidhin me realizmin e të hyrave përmes transaksioneve bankare.
27. Më 25 maj 2018, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
28. Më 8 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimin [A. A. nr. 373/2018] e refuzoj ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoj Aktgjykimin [A. nr. 1937/16] e Gjykatës Themelore, të 15 marsit 2018.
29. Më 28 qershor 2019, parashtruesi parashtrroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
30. Më 4 korrik 2019, parashtruesi parashtrroi kërkesë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit duke kërkuar që të iniciojë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [A. A. nr. 373/2018] të Gjykatës së Apelit.

31. Më 7 tetor 2016, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit me Njoftimin [KMLA. nr. 13/2019] e informoi parashtruesin e kërkesës se nuk është e nevojshme aprovimi i propozimit të tij, duke qene që parashtruesi kishte parashtruar kërkesën për mbrojtjen e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë në Gjykatën Supreme.
32. Më 9 dhjetor 2019, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP nr. 107/2019] e refuzoj kërkesën e parashtruesit si të pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar [ARJ.UZVP.nr. 107/2019] i 9 dhjetorit 2019 i Gjykatës Supreme, është nxjerre në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore të garantuara përmes neneve 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] e 46 [Mbrojtja e Pronës], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
34. Parashtruesi i kërkesës së pari konsideron se çështja kryesore në lidhje me tatimet detyruese është se ai nuk ka ushtruar aktiviteti biznesore dhe të hyrat në llogarinë personale janë trajtuar si të hyra nga aktiviteti biznesore pa u mbështetura në ndonjë prove konkrete nga ana e gjykatave të rregullta.
35. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se mos shqyrtimi i provave, refuzimi i dëshmitarit të propozuar si dhe mos arsyetimi i refuzimit të kërkesës për ekspertizë financiare nga Gjykata Themelore ka shkaktuar shkelje të nenit 24 dhe 31 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe të të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor.
36. Në vazhdim, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Edhe aktgjykimi i gjykatës se shkallës së tretë, se gjykatës se shkallës së parë dhe të dytë kanë shkelur ligjin me mos dhënien e mundësisë së parashtruesit të kërkesës që të dëshmoj pretendimin e tij, në mënyrë të cilin ai e ka konsideruar se e dëshmon mjaftueshëm - përmes nxjerrjes së ekspertizës financiare, me të cilin do të hidheshin poshtë si të pabazuara të gjithë arsyet te cilat kanë dërguar në marrjen e vendimit të Administratës Tatimore të Kosovës, në të cilin janë konstatuar fakte vetvetiu pa u vërtetuar të njëjtat.”*
37. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se refuzimi për konstatim të gjendjes faktike përmes ekspertizës financiare në rastin e tij nga ana e gjykatave të rregullta, ka shkaktuar shkelje të nenit 81 të Ligjit nr. 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/l-222, nenin 7 dhe 319 të Ligjit Nr. 03/l-006 për Procedurën Kontestimore.
38. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Kur gjykata refuzojnë kërkesa për mjete provuese, ata duhet të japin arsye të mjaftueshme dhe refuzimi nuk duhet të jete njollosur nga arbitrariteti, nuk duhet të përbej një kufizim disproporcional të aftësisë së palës ndërgjyqësi për të paraqitur argumente në mbështetje të çështje se tij. Nëse refuzohen mjetet provuese, atëherë mund të shkelet parimi i barazisë së armëve.”*

39. Me tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se *“përmes ekspertizës financiare, ka pasur për të vëne në pah se transaksionet e realizuara ne xhirollogarinë private te tij, nuk kane qene vetëm qarkullime te parasë te bëra nder vite nga i njëjti. Gjykata e shkalles se parë kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit te kërkesës, të njëjtin e ka pamundësuar që të provoj thëniet e ngritura në konfliktin administrativ”*
40. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjerash, thekson *“Gjykata e shkallës se parë ka treguar anësi në favor të Administratës Tatimore të Kosovës, pasi që kjo e fundit, prej gjykatës nuk është detyruar që të vërtetoj faktet të cilat i kanë mbështetur në kërkesën e saj, por barrën e provës e ka lenë vetëm ne parashtruesin e kërkesës”*
41. Parashtruesi i kërkesës nënvizon se *“ATK vetëm ka nxjerr konstatimin se parashtruesi i kërkesës Enver Maloku, ne cilësinë e personit fizik, ne xhirollogarinë privatë të tij, ka qarkulluar mjete lidhur me veprimtaria afariste, por gjykata nuk e ka obliguar të njëjtin që t'i vërtetoj se cilat kanë qenë ato veprimtari afariste të cilat i ka zhvilluar tatimpaguesi*
42. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta (i) deklaroje kërkesën e tij të pranueshme; (ii) të konstatoje shkelje të neneve 3, 7, 31 dhe 46 të Kushtetutës; (iii) të shpalle të pavlefshëm Aktgjykimin [ARJ.UZVP.nr. 107/2019] e 9 dhjetorit 2019 të Gjykatës Supreme dhe (iv) të ktheje çështjen e tij në rivendosje në Gjykatën Supreme.

Pranueshmëria e kërkesës

43. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të përcaktuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
44. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113. [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrënë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
45. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

46. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [ARJ-UZVP.nr. 107/2019], të 9 dhjetorit 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se u janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmerise të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmerise) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

47. Gjykata, fillimisht thekson që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

48. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
49. Gjykata rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me tatimin e ngarkuar ndaj parashtruesit të kërkesës nga ana e ATK-së në vlerë prej 46,983.50 €, si dhe gjobën në vlerë prej 25%, për periudhën 1 prill 2010 deri me 31 dhjetor 2015. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankese në Departamentin për Ankesa të ATK-së e cila u refuzua si e pabazuar nga kjo e fundit. Me pas, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankese në Gjykatën Themelore kundër ATK-së me arsyetimin se kjo e fundit me rastin kur e ka ngarkuar parashtruesin e kërkesës si tatimpagues me TVSH, në mënyrë të gabuar ka interpretuar dhe zbatuar dispozitat e Ligjit për TVSH-në, gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk ka ushtruar veprimtari afariste dhe nuk ka realizuar ndonjë transaksion biznesore. Me tej, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Themelore kishte theksuar se parat në llogarinë e tij personale janë trajtuar si të hyra biznesore pa asnjë fakt dhe prove dhe kjo ka shkaktuar që parashtruesi të ngarkohet me tatim. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Themelore kishte kërkuar ekspertizë financiare në mënyrë që të konstatohet drejt gjendja faktike. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A. nr. 1937/16] e refuzoj ankesën e parashtruesit të kërkesës, si të pabazuar bashkë me kërkesën për ekspertizë financiare. Parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën e Apelit duke kontestuar vendimin e Gjykatës Themelore përfshirë edhe refuzimin për caktimin e ekspertit financiar. Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [A. A. nr. 373/2018] e refuzoj ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [A. nr. 1937/16] e Gjykatës Themelore, të 15 marsit 2018. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në Gjykatën Supreme duke pretenduar zbatimit të gabuar të të drejtës materiale dhe shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore si rezultat i mos mbajtje se seancës publike; mos shqyrtimi i provave duke kontestuar po ashtu edhe refuzimin e kërkesës për caktimin e ekspertit financiar në rastin e tij. Por, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [ARJ-UZVP nr. 107/2019] e refuzoj kërkesën e parashtruesit si të pabazuar. Këtë konstatim të Gjykatës Supreme dhe mos shqyrtimi i provave nga ana e gjykatave të rregullta; refuzimi i dëshmitarit të propozuar si dhe mos arsyetimi i refuzimit të kërkesës për ekspertizë financiare në rastin e tij, parashtruesi i kërkesës i konteston edhe para Gjykatës.
50. Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës pretendon se mos shqyrtimi i provave të paraqitura, refuzimi dhe mos arsyetimi i refuzimit të kërkesës për caktimin e ekspertit financiar bashkë me refuzimin e dëshmitarit ka rezultuar në konstatim të gabuar të gjendjes faktike në rrethanat e rastit të tij nga ana e gjykatave të rregullta dhe për pasoje është ngarkuar me tatim në mënyrë të padrejte sepse sipas tij, parashtruesi nuk ka ushtruar aktiviteti biznesore dhe se të hyrat në llogarinë personale janë trajtuar si të hyra nga aktiviteti biznesore pa u mbështetura në ndonjë prove konkrete.

51. Këto pretendime, parashtruesi i kërkesës i ngrit para Gjykatës, duke pretenduar në esencë, shkëlje të parimit të barazisë së armeve dhe të drejtës për vendim të arsyetuar në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të konstatimi të gabuar të gjendjes faktike; mos shqyrtimi i provave; refuzimi i dëshmitarit të propozuar si dhe mos arsyetimi i refuzimit të kërkesës për ekspertizë financiare nga ana e gjykatave të rregullta.
52. Në fakt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i referohet neneve 3, 7, 24, 31, 46 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, në esencë të gjitha pohimet e parashtruesit janë të ndërlidhura me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
53. Në këtë drejtim, Gjykata se pari thekson se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar, është të iu tregojë palëve se janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të këtë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë (shih, mutatis mutandis, rastet e GJEDNJ-së, Hirvisaari kundër Finlandës, nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30; dhe shih, gjithashtu, Suominen kundër Finlandës, nr. 37007/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003 paragrafi 37; si dhe shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI97/16 parashtrues IKK Classic, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 46).
54. Gjykata thekson se, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument (shih, gjithashtu, rastin e GJEDNJ-se, Van de Hurk kundër Holandës, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61), argumentet kryesore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen (shih rastet e GJEDNJ-se, Buzescu kundër Rumanisë, nr. 61302/00, Aktgjykimi i 24 majit 2005 dhe Pronina kundër Ukrainas, nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006). Po ashtu, dhënia e një arsyeje për një vendim që nuk është një arsye e mirë në ligj nuk do të përmbushë kriteret e nenit 6 (shih rastin e GJEDNJ-se De Moor kundër Belgjikës nr. 16997/90, Aktgjykimi i 23 qershorit 1994 si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese IKK Classic, cituar me lart, paragrafi 51).
55. Së pari, përkitazi me pretendimet specifike të cituara me lartë të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të i riprodhojë pjesët relevante të vendimeve të gjykatave të rregullta, ku parashtruesi i kërkesës i konteston në mbështetje të pretendimeve të tij.
56. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [A. nr. 1937/16] të 15 marsit 2018 kishte sqaruar si në vijim:

“Më qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit publik të datës; 15.03.2018, ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi nr.333/2016 i date 13.09.2016 nga ATK-së, ankesa e paditësit drejtuar ATK-së, Raporti i kontrollit, transferet bankare, kontrate punësimi, kontrate për huazimin e mjeteve financiare.

Gjykata konfirmo dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe

Procedurat nr.03/L-222, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestuese, thëniet ne ankesë-padi, përgjigje në padi, shkresa të lëndës në këtë konflikt administrative, dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesore, konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Në arsyetimin e vendimit kontestuese e paditur thekson se kontrolli vlerësimi e ka mbështet ne nenin 14, 15 dhe 16 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Në mungesë të regjistrimeve sikurse parashihet me nenin 13 të Ligjit 03/L-222, kontroll ka aplikuar metodat indirekte të parapara me nenin 30 të Udhëzimit Administrativ nr.15/200 dhe e ke vlerësuar paditësin në bazë të metodës se depozitave bankare dhe shpenzimeve të cash-it. E paditura me tej thekson se paditësi nuk ka arrit të dokumentoj shpenzimet sipas nenit 15 para. 5 të Ligjit 03/L-161 për TAP dhe nenit 10 pa. 1 të UA 13/2010.

Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësore, paditësi i ka bashkëngjitur padis kartelën financiare, kontratën e punës të paditësit tek subjekti “Të Papaku”, kontratën e punës te V.M. Paditësi nuk i ka dëshmuar gjykatës provat materiale që kanë të bëjnë me prejardhjen e deponimeve bankare në periudhën 2011-2015 në bazë të cilave ka rezultuar tatimi shtesë.”

57. Në vazhdim, Gjykata rikujton që Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimin [A. A. nr. 373/2018] të 8 majit 2019, kishte arsyetuar si më poshtë:

“Kolegji vlerëson se gjykata e shkalles se pare ka vlerësuar drejte ligjshmërinë e aktit përfundimtar-vendimit të atakuar nga paditësi, si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, në të cilin aktvendim në procedure administrative e gjithashtu sipas aktgjykimin të ankimuar me ankesë, edhe në procedure gjyqësore në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike e çështjes në shqyrtim, për arsye se evidencat e tatimpaguesit nuk kanë qenë të sakta dhe të besueshme prandaj, vlerësimi tatimor i ATK-së për paditësin, përmes aplikimit të metodave indirekte të vlerësimit, konform dispozitës se nenit 30 të Udhëzimit Administrative nr.15/2010, është bërë llogaritja e detyrimit tatimor me Metodën e Depozitave bankare dhe Shpenzimeve të Keshit, pasi që paditësi nuk i ka dokumentuar shpenzimet sipas nenit 15 para, 5 të Ligjit nr. 03/L-161 për TAP dhe nenin 10 par.1 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010, është bërë llogaritja e detyrimit tatimor me Metodën e Depozitave bankare dhe Shpenzimeve te Keshit, pasi që paditësi nuk i ka dokumentuar shpenzimet sipas nenit 15 par.5 të Ligjit nr.03/L161 për TAP dhe nenin 10 par.1 të Udhëzimit Administrativ.

Nga të lartë cekurat kolegji vlerëson se Gjykata e shkalles se parë dhe organi i paditur-ATK, kanë vendosur drejtë dhe në bazë ligjore Njoftim Rivlerësimet e kontrollit me të cilat paditësi është ngarkuar me tatim shtese për arsye se të hyrat nga deponimet bankare nuk ka qenë në gjendje ti dëshmoj nga e kanë prejardhjen.”

58. Në fund, Gjykata do të iu referohet edhe pjesës relevante të Aktgjykimin të [ARJ-UZVP nr. 107/2019] të 9 dhjetorit 2019 të Gjykatës Supreme, e cila kishte arsyetuar si në vijim:

“Nga shkresat e lëndës është vërtetuar padyshim që në mungesë të regjistrimeve, ashtu si edhe e parashikon neni 13 i Ligjit të cekur, me rastin e kontrollit të kryer është aplikuar metoda indirekte sikurse parashihet më nenin 30 të Udhëzimit Administrative nr.15/2010, duke marrë për bazë metodën e depozitave bankare dhe shpenzimeve të "cashit". Nga ekzaminimi i dokumentacionit prej palëve të treta - banka PCB dhe RBKO për periudhën kontrolluese, kontrolli ka konstatuar deponime në total prej 187,852.30 € në formë të qarkullimit financiar ku paditësi nuk ka arritur me asnjë argument dhe prove material të dëshmoj se mjetet e përshkruara në ekstrakte bankare si deponime e kanë burimin në ndonjë burim i pa tatueshëm i mjeteve, siç parashikone neni 19.6 i ligjit të lartë përmendur, prandaj i njëjti është trajtuar si person fizik, gjegjësisht si obligues tatimor në kuptim të nenit 1.26.1 Ligjit të cekur dhe nenit 3 të Ligjit për Tatim në të Ardhurat Personale Nr. 03/L-222, ku për t'u identifikuar si tatimpagues në sistemin SIGTAS, e paditura në pajtim me procedurat ligjore ia ka lëshuar numrin fiskal 601057913. Ndërsa, e paditura në anën tjetër për periudhën kontrolluese 04/2010 deri me 03/2016 ka përfshire vetëm vlerën e deponimeve prej 187.852,30 euro edhe atë si qarkullim shtesë nga i cili ka rezultuar tatimi shtesë, me çka vërtetohet se pretendimet e paditësit janë të paargumentuara dhe të paqëndrueshme.

Në fakt, paditësi nuk ka arritur të argumentoj se nga i cili aktivitet i zhvilluar e kanë burimin mjetet e deponuara në banka, gjegjësisht nuk ka arritur të arsyetoj faktin se mjetet e deponuara e kanë burimin nga ndonjë burim i liruar nga tatimet. E paditura ka llogaritura vetëm deponimet në kontot e paditësit dhe nuk ka marrë parasysh tërheqjet e tyre sipas nevojës e me vonë rideponimet e parave të njëjta, për arsye se paditësi në rastin konkrete nuk është ngarkuar me qarkullim shtesë për vlerën e deponimeve ku kontrolli e ka vlerësuar se ato janë transfere bankare apo se janë lëvizje të cash-it. Pra, në rastin konkrete është marrë vetëm ajo vlerë e deponimeve për të cilat është gjykuar se janë nga burimi i tatueshëm, pasi që nuk është ofruar asnjë provë e besueshme të cilat do të vërtetonin të kundërtën, se diferencat e deponimeve të trajtuara shtesë nëpër periudha tatimore nuk janë burimi i pa tatueshëm i mjeteve.

Pasi që paditësi nuk ka krijuar dhe mbajtura regjistrimet e posaçme në pajtim me ligjin në fuqi për tatime ashtu siç e parasheh neni 13 i Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurën nr. 03/L-222 dhe me nenin 17 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, e paditura ka aplikuar drejte metodën indirekte në pajtim me nenin 19.3 të Ligjit të cekur, duke vlerësuar obligimin tatimore në bazë të metodës të depozitave bankare dhe shpenzimeve të keshit me të cilin llogariten të ardhurat duke treguar gjendjen financiare (fondet e paditësit), e cila njherit është bazuar në faktin që kur një tatimpagues merr para, janë të mundura vetëm dy gjera, e para se e njëjta mund të depozitohet dhe e dyta që parat e njëjta mund të shpenzohen. Kjo vetëm vërteton bazën ligjore të vlerësimit për deponimet të cilat nuk ka mundur ti arsyetoj paditësi, dhe gjithashtu edhe origjinën e tyre me të cilin do të mundë të vërtetohet burimi i të ardhurave, gjegjësisht se a janë të liruara nga tatimet këto mjete.”

59. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesë pretendon konstatim të gabuar të gjendjes faktike në rrethanat e rastit të tij nga ana e gjykatave të rregullta dhe kjo ka rezultuar që parashtruesi të ngarkohet me tatimi në mënyrë të padrejtë, edhe pse sipas tij, nuk ka ushtruar aktiviteti biznesore dhe se të hyrat në llogarinë personale janë trajtuar si të hyra nga aktiviteti biznesore pa u mbështetura në ndonjë prove konkrete.
60. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se gjykatat e rregullta vendimet e tyre i kishin bazuar në prova dhe dokumente tjera relevante dhe me pas kishin refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës bashkë me kërkesën për ekspertizë financiare.
61. Gjykata verën se ATK-ja në mungese të regjistrave dhe dokumentacionit tjetër relevante nga ana e parashtruesit, kishte vlerësuar tatimin e parashtruesit të kërkesës në bazë të metodës indirekte të mbështetur në paragrafin 3 të nenit 19 të Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për ATK-në) i cili përcakton si në vijim:

*“Në qoftë se librat dhe regjistrimet e tatimpaguesit kanë humbur apo janë shkatërruar ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e detyrimit tatimor, Drejtori i Përgjithshëm do të bëjë një vlerësim bazuar në një parashikim. Parashikimi duhet të bazohet në mjetet, të ardhurat qarkulluese, shpenzimet e prodhimit, shpenzimet krahasuese, dhe **metodat tjera direkte dhe indirekte që lidhen me llogaritjen e detyrimit tatimor.**”*

62. Gjykata verën se në rastin konkrete parashtruesi është ngarkuar me tatim mbi vlerën e deponimeve për të cilat është gjykuar se rrjedhin nga një burimi i tatuësëm dhe se parashtruesi i kërkesës kishte dështuar që para gjykatave të rregullta të dëshmojë se mjetet monetare në llogarinë bankare janë të liruar nga tatimi.
63. Saj përket pretendimet të parashtruesit të kërkesës se nuk ka ushtruar asnjë veprimtari afariste, Gjykata verën se ATK-ja e kishte trajtuar parashtruesin e kërkesës si person obligues tatimore duke e pajisura përmes numrit fiskal 601057913.
64. Gjykata verën se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre duke u bazuar në dokumentacionet bankare të palëve të treta për periudhën kontrolluese të parashtruesit të kërkesës, përcaktuan se kanë qarkulluar deponime në vlerë prej 187,852.30 euro në formë të qarkullimit financiare, ku parashtruesi i kërkesës nuk kishte arritur që të dëshmojë para gjykatave të rregullta se origjina e këtyre deponimeve vjen nga një burim i patatuësëm.
65. Gjykata konsideron se pretendimet për mënyrën e te vërtetuarit të gjendjes faktike përbejnë çështje të faktit dhe të ligjit çka është detyrë dhe prerogativë e gjykatave të rregullta. Gjykata bazuar në parimin e subsidiaritetit nuk mund t'i zëvendësojë vendimet e veta me ato të gjykatave të rregullta.
66. Për me tepër, si rregull i përgjithshëm, vërtetimi i fakteve të rastit dhe interpretimi i ligjit janë parimisht çështje për gjykatat e rregullta, gjetjet dhe

konkluzionet e të cilëve në këtë drejtim janë të detyrueshme për Gjykatën. Megjithatë, kur një vendim i një gjykate të rregullt është qartazi arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta vë atë në dyshim (shih Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë, [GC], kërkesa nr. 60654/00, Aktgjykimi i 15 janarit 2007, para 89).

67. Nga sa më sipër, Gjykata ripërsërit se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç nëse dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo nuk mundet vetë të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend se një tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, çka do të nënkuptonte shpërfillje të kufijve të juridiksionit të saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e Gjykatës nr. KI13/16, parashtrues Armend Selimi, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 tetorit 2016).
68. Gjykata sjell ne vëmendje pretendimin e parashtruesi të kërkesës lidhur me refuzimin dhe mos arsyetimin e refuzimit të kërkesës për caktimin e ekspertit financiarë në rastin e tij nga ana e gjykatave të rregullta.
69. Gjykata verën se kërkesa për ekspertizë financiare në rastin e tij ishte refuzuar nga Gjykata Themelore me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte bashkangjitur asnjë dokumentacion që ka të bej me të hyrat e realizuara përmes transaksioneve bankare dhe se nuk ekzistonte ndonjë dëshmi tjetër që do të ndryshonte gjendjen faktike në rastin e parashtruesit të kërkesës.
70. Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Themelore duke mos paraqitur dokumentacionin e nevojshëm kishte dështuar që të i mbështes pretendimet e tij lidhur me çështjen e tatimit dhe mos ushtrimin te veprimtarisë afariste dhe për pasojë ishte refuzuar kërkesa për caktimin e ekspertit financiar.
71. Gjykata verën se vendimi për të refuzuar ekspertizën financiare mund të duket në pamje të parë i hapur ndaj kritikave. Megjithatë, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta, përkatësisht Gjykata Themelore gjatë vendimmarrjes kishte në dispozicion provat relevante si vendimin [nr.333/2016] e ATK-së, pretendimet e parashtruesit drejtuar ATK-së, raportin e kontrollit, transferet bankare, kontratën e punësimiti etj.
72. Gjykata thekson se refuzimi për të urdhëruar një mendim eksperti nuk është, në vetvete, i padrejtë; Gjykata duhet të konstatojë nëse procedurat në tërësi ishin të drejta. Duke pasur parasysh të gjitha këto rrethana në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kishin të drejtë të mbanin mendimin se kishin informacion të mjaftueshëm për të qenë në gjendje të jepnin gjykim në bazë të shqyrtimit paraprak të çështjes dhe provave para tyre. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *H. Kundër Francës*, Aktgjykim i 24 tetorit 1989).
73. Gjykata vlerëson që parashtruesit të kërkesës i është dhënë një mundësi e përshtatshme dhe e duhur për të paraqitur rastin e tij dhe në përputhje me rrethanat e rastit dhe argumentimin e pretendimeve të parashtruesit të

kërkesës, fakti që nuk që nuk është urdhëruar një ekspertizë financiare nuk cenon të drejtën e parashtruesit për një gjykim të drejtë.

74. Gjykata përsërit se neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës, i obligon gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si obligim i gjykatës për të dhënë përgjigje të hollësishme në çdo argument të parashtruesit të kërkesës (shih rastin e GJEDNJ-se, Van de Hurk kundër Holandës, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61). Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit. Ajo gjithashtu duhet të marre parasysh, ndër të tjera, shumëllojshmërinë e parashtrësive të paraqitura nga një palë në procedurat që mund të bëjnë që gjykata të japin mendime dhe përfundime të ndryshme ligjore gjatë marrjes së vendimeve. Prandaj, pyetja nëse gjykata ka përmbushur detyrimin për të shpjeguar arsyet për vendimin e saj, që rrjedh nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm nën dritën e rrethanave të secilit rast individual.
75. Gjykata rikujton se e drejta për një "proces të drejtë" në procedurat civile dhe penale, e cila kërkohet nga neni 6 i KEDNJ-së, nuk është drejtësi "materiale" por është drejtësi "procedurale". Në aspektin praktik kjo nënkupton se palët e kanë të drejtën për një procedure kontradiktore në të cilën merren parasysh parashtrësit e palëve dhe në të cilën palët janë të vendosura në pozite të barabarte para gjykatës (shih rastet e GJEDNJ, Star Cate Epilekta Gevmata dhe të tjerët kundër Greqisë, nr. 54111/07, Vendimi i 6 korrikut 2010; Donadze kundër Gjeorgjisë, nr. 74644/01, Vendimi i 7 marsit 2006, paragrafët 30-31).
76. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet se gjatë procedurave gjyqësore nuk ka përfituar nga një procedure kontradiktore; se nuk kanë pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesin pretendimet dhe provat të cilat i kanë konsideruar si të rëndësishme për rastin e tyre; që nuk kanë pasur mundësinë për t'i kundërshtuar pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare; që gjykatat nuk i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tyre, e të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, dhe se arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar nuk janë paraqitur në detaje nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Prandaj, Gjykata konsideron se procedura, shikuar në tërësinë e saj, ishte e drejtë (shih rastin e GJEDNJ-se, Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 35394/97, Vendimi i 4 tetorit 2000).
77. Gjykata, me tej, thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurave nga gjykatat e rregullta nuk mundet vetvetiu të paraqesë pretendim të argumentueshëm për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, mutatis mutandis, rastin e GJEDNJ-se, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Vendimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
78. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm e parashtruesit të kërkesës nuk i është shkelur nga vendimet e autoriteteve publike.

79. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që dëshmojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë shkaktuar shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetute, gjegjësisht me nenet 24, 31 dhe 46 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
80. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PER KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, me 10 dhjetor 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TE DEKLAROJE kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJE këtë vendim palëve;
- III. TE PUBLIKOJE këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka Nimani